

STATUT I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"CBLS-Telemed "sh.p.k

Në këtë statut

- "Ligi" ështe Ligji Nr. 9901 dt.14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqërите tregtare".
- "Statuti" është Statuti i shoqerisë.

KREU I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

- (1) Sot më datën 24.11.2020, unë themeluesi, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin CBLS-Telemed SH.P.K.
- (2) Themelues i shoqerisë është

Arsi Ibro, shtetas shqiptar, i datëlindjes 11.06.1996, i biri i Ndriçimit, lindur në Tiranë

Emërtimi "CBLS-Telemed"sh.p.k dhe emri i administratorit do të figurojnë në të gjitha aktet ose dokumentet e nxjerra nga shoqëria dhe që u drejtohen të tretëve.

Neni 2

Objekti

Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është

- Shërbim i Telemjekesisë, shërbim shëndetësor në distancë, i mundësuar nëpërmjet Teknologjisë së Telemedicinës, që aplikon Sisteme me komponente hardware dhe software të lidhur së bashku, për të krijuar një shtrat të sigurt transferimi për informacionin shëndetësor nëpërmjet teknologjisë së avancuar të telekomunikacionit.
- Ndërtimin e qendrave shëndetësore.
- Import-eksport paisjesh mjekësore apo ndihmëse mjekësore, paisjesh elektronike në përgjithësi, paisje zyrash, mallrash...etj

Neni 3

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit.

Neni 4

Selia

Shoqëria do ta ketë selinë qendrore në adresën Mushqeta, Tiranë, Në zonën kadastrale 2752 në pasurinë me Nr. 110/3.



Shoqëria mund të hapë edhe zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, dhe/ose të realizojë çdo lloj pjesëmarrje të parashikuar nga ligji në shoqëri të tjera, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

KREU II

Kapitali

Neni 5

Kapitali Themeltar

(1) Kapitali fillestar i shoqërisë është 100 lekë

Ortaku i vetëm i shoqërisë është zotërues i 100% të kapitalit të shoqërisë

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute, sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakëtnë të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre, mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- Shitblerjes
- Trashëgimisë
- Dhurimit
- Çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi vendimmarrës

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çeshtjet e mëposhtme:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b. Ndryshimin e statutit
- c. Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- d. Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe të ekspertëve kontabel të autorizuar
- e. Përcaktimin e shpërblimeve për personave të përmendur nëshkronjat c dhe d te kësaj pike
- f. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirëpërgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- i. Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre
- j. Perfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë
- m. Çeshtje të tjera të parashikuaranga ligji apo statuti

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi, nga një ortak tjetër, apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëvenë asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin dhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime te vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime te vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30% të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çeshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuarsipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime te vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të

votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikes 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të permendor më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruarve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarres, për ndryshimin e statutit, zmudhimin dhe zgjedhimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- Percaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- Emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të miratuar
- Percaktimin e shpërblimeve
- Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- Përfaqësimin e shoqërisë në Gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë

Çdo ndryshim statutit duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

- Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - Vlerësimin e veprimtarisë së tij
 - Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij
 - Ngritjen e ndonjë padie ndaj tij nga shoqëria
 - Dhënien ose jo të përfitimeve të reja
- Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuar i vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku të cilin ai përfaqëson

Neni 13

Administrimi

- Asambleja e përgjithshme emeron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritit është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit
- Administratorët e një shoqërie mëmë, sipas percaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administrator të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm
- Personi i mëposhtëm caktohet si administrator i parë i shoqërisë.

Arsi Ibro, shtetas shqiptar, i datëlindjes 11.06.1996, I biri I Ndriçimit, lindur në Tiranë.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë dhe detyrohen të:

- a) Kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga asambleja e përgjithshme
- b) Përfaqësojnë shoqërinë tregtare
- c) Kujdesen përmajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë
- d) Përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim
- e) Krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- g) Raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe meralizimin e vepimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare
- h) Kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut

Administratorët janë të detyruar të thërasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet kur

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktivet, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 përqind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara

Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë ne çdo kohë administratorët, me shumicë të zakonshme. Paditë që lidhen me shpërbllimin e administratorit, në bazë të marrëdheneve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjesitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë, ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo përfajë të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen



administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17, e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" administratori detyrohet:

1. a) Të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim dhe në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjeshtë.

b) Të ushtrojë kompetencat që i njihen me ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita.

c) Të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim.

ç) Të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të shoqërisë.

d) Të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 1 dhe 2 të këtij neni, është i detyruar të dëmshpérblejë ndaj shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ai apo personat e lidhur me të kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kérkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisëdëmet e shkaktuara nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) U kthen ortakëve kontributet
- b) U paguan ortakëve interesa apo dividendë
- c) U shpérndan aktivet shoqërisë
- d) Lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur në bazë të gjendjes financiare, duhej t'ë parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet
- e) Jep kredi

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose së bashku, kanë të drejtën të ngrenë padi penale ndaj administratorit. Paditëstit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë dhe dëmshpérblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit përgabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV

Viti finansiar-ekspertët

Neni 16

Viti finansiar

Viti finansiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qëndrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët

Eksperti ka per detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimitarisë ekonomiko-trgtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për njerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor, si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar t'ja paraqesë e dorrëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtaur e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore që ka.

KREU V

Prishja- Riorganizimi i shoqerisë

Neni 18

Prishja dhe likujdimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj
- Me vendim të asamblesë së ortakëve
- Me hapjen e procedurave të falimentimit
- Nëse nuk ka kryer veprime tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimitarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007
“Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”
- Me vendim të Gjykatës

Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilën parashikojnë menyrën e likujdimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të njerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në Likujdim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likujdimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim te rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likujdimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga ortakët.

Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likujdusve brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likujdus.

Neni 19

Riorganizimi I shoqërisë bashkim-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore, të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21


Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin nëlidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKU

I Shoqërisë CBLS-Telemed

Arsi Ibro


Arsi Ibro